

Vendim nr. 84 datë 23.12.2024

(V-84/24)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Marsida Xhaferllari, Kryesuese, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datat 12, 13, 16, 17 dhe 23.12.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 25 (K) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **KRYETARJA E GJYKATËS KUSHTETUESE**, zonja Holta Zaçaj.

OBJEKTI: **Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese, zonjës Holta Zaçaj.**

BAZA LIGJORE: Neni 127, pikat 1, shkronja “c” dhe 2, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 8, pika 3 dhe 9, pikat 1, shkronja “c” dhe 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën dhe opinionin me shkrim të Kryetares së Gjykatës Kushtetuese, e cila u shpreh se mandati i saj si gjyqtare mbaron në datën 31.12.2025, administroi dokumentacionin e nevojshëm, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 2, datë 16.01.2023, ka vendosur: “Zgjedhjen e znj. Holta Zaçaj anëtare të Gjykatës Kushtetuese me

mandat të pjesshëm, deri në kryerjen e ripërtëritjes në vitin 2025.”. Në datën 25.01.2023 zonja Holta Zaçaj ka bërë betimin përpara Presidentit të Republikës dhe ka filluar të ushtrojë detyrën e anëtares së Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*). Ndërsa në datën 20.02.2023, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve, ajo është zgjedhur Kryetare e kësaj Gjykate.

2. Në lidhje me mbarimin e mandatit të saj si gjyqtare, në datën 10.12.2024 Kryetarja e Gjykatës i është drejtuar Komisionit të Venecias me kërkesë për dhënien e një opinioni *amicus curiae*, duke parashtruar disa pyetje, mes të tjerash edhe në lidhje me mënyrën e përlogaritjes së datës së mbarimit të gjyqtarëve kushtetues, për të cilët dispozitat kalimtare kushtetuese kanë përcaktuar vetëm vitin e qëndrimit në detyrë.

3. Në datën 11.12.2024 kryetari i Gjykatës së Lartë, në cilësinë e kryetarit të organit të emërtesës për pozicionin në të cilin është zgjedhur gjyqtarja Holta Zaçaj, ka njoftuar hapjen e procedurës për zgjedhjen nga Gjykata e Lartë të anëtarit të ri të Gjykatës Kushtetuese, ku sipas njoftimit, mandati i gjyqtarës në fjalë përfundonte në datën 10.03.2025.

4. Duke marrë shkas nga njoftimi i kryetarit të Gjykatës së Lartë, Kryetarja e Gjykatës, në datën 12.12.2024, bazuar në nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, ka paraqitur përpara kësaj Gjykate kërkesën për deklarin e mbarimit të mandatit të saj si gjyqtare, duke shprehur mendimin se mandati i saj përfundonte në datën 31.12.2025. Gjykata, pasi u njoh me kërkesën në këtë datë dhe vlerësoi se për shqyrtimin e saj ishte e nevojshme përgatitja e materialeve në lidhje me rastin, caktoi datën 13.12.2024 për shqyrtimin e kërkesës.

5. Në seancën plenare të datës 13.12.2024 Gjykata çmoi se ishte i nevojshëm administrimi i praktikës dokumentare të Gjykatës së Lartë që ka shoqëruar procedurën për plotësimin e vendit vakant dhe zgjedhjen e zonjës Holta Zaçaj si anëtare të Gjykatës, të përmbyllur me vendimin e saj nr. 2, datë 16.01.2023, ashtu edhe i njoftimit të datës 11.12.2024 të kryetarit të Gjykatës së Lartë për hapjen e procedurës për zgjedhjen e anëtarit të ri të Gjykatës Kushtetuese. Në pritje të dërgimit të dokumentacionit të kërkuar, Gjykata vendosi të shtyjë seancën më 16.12.2024. Në vijim, në seancën e kësaj date, Gjykata administroi praktikën dokumentare të kërkuar për nevoja të këtij shqyrtimi dhe vlerësoi që këto akte t'i komunikohen gjyqtarës Holta Zaçaj, njëherazi edhe Kryetare e Gjykatës, e cila ka vënë në lëvizje procesin, me qëllimin për t'u njohur dhe për të vlerësuar paraqitjen e një opinioni me shkrim në lidhje me to. Në seancën e radhës të datës

17.12.2024 Gjykata konstatoi se gjyqtarja Holta Zaçaj, pasi është njohur me praktikën dokumentare të dërguar nga Gjykata e Lartë, ka paraqitur një kërkesë me shkrim për dhënien e një kohe të mjaftueshme për të parashtruar opinionin e saj në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga kryetari i Gjykatës së Lartë për sa u përket parimeve kushtetuese dhe mënyrës së interpretimit të dispozitave kushtetuese të zbatueshme në rastin në shqyrtim. Gjykata, pasi vlerësoi shkaqet e kësaj kërkesë, vendosi ta pranojë atë, duke shtyrë seancën për më 23.12.2024.

6. Në seancën e datës 23.12.2024 Gjykata administroi opinionin me shkrim të Kryetares së Gjykatës për mënyrën e interpretimit të dispozitave kushtetuese dhe atyre ligjore të zbatueshme në rastin në shqyrtim, si dhe në lidhje me qëndrimin dhe veprimet e kryetarit të Gjykatës së Lartë. Në vlerësimin e Kryetares së Gjykatës, në interpretim të nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, jurisprudencës kushtetuese, dispozitave të ligjit nr. 8577/2000 të Gjykatës, si dhe rregullave të përgjithshme të së drejtës, data e mbarimit të kohës së qëndrimit të saj në detyrën e gjyqtares është dita e fundit e muajit të fundit të vitit 2025, për sa kohë që Kushtetuta nuk ka përcaktuar as ndonjë datë, as ndonjë ngjarje juridike nga e cila të mund të përcaktohet një datë e ndryshme nga data 31.12.2025. Për rrjedhojë, ajo ka kërkuar: (a) deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtares Holta Zaçaj në datën 31.12.2025; (b) deklarimin se hapja e procedurës së aplikimit për gjyqtarin pasues nuk mund të fillojë përpara datës 30.09.2025; (c) deklarimin si jokushtetues dhe absolutisht të pavlefshëm të aktit “Njoftim” të kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe të çdo veprimi apo procedure të bazuar në këtë akt.

7. Gjykata konstatoi, gjithashtu, se Kryetarja e Gjykatës ka paraqitur edhe disa kërkesa procedurale dhe konkretisht: i) pezullimin e shqyrtimit të çështjes deri në dhënien e opinionit nga Komisioni i Venecias për kërkesën e bërë prej saj në datën 10.12.2024; ose ii) kërkimin nga vetë Gjykata të një opinionin *amicus curiae* nga ai organ këshillimor dhe pezullimin e shqyrtimit për këtë shkak; iii) pezullimin e zbatimit të aktit “Njoftim” të kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe procedurave të bazuara/inicuar mbi atë akt.

8. Në lidhje me kërkesën për pezullimin e shqyrtimit të çështjes deri në dhënien e opinionit të Komisionit të Venecias sipas kërkesës së bërë nga Kryetarja e Gjykatës në datën 10.12.2024, Gjykata vërejti se sipas nenit 44/b të ligjit nr. 8577/2000, gjatë shqyrtimit të çështjes, ajo mund të vendosë të kërkojë opinione *amicus curiae* nga organizma të tjerë, siç është edhe

Komisioni i Venecias, rast në të cilin vendoset pezullimi i shqyrtimit të çështjes deri në marrjen e këtij opinioni. Kjo dispozitë është reflektuar edhe në nenin 35 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (*Rregullorja e Gjykatës*), sipas të cilit kur çështja ka kaluar për shqyrtim në seancë plenare, çdo gjyqtar mund të propozojë edhe marrjen e një opinioni *amicus curiae* nga Komisioni i Venecias ose organizma të tjerë, rast në të cilin vendoset pezullimi i shqyrtimit të çështjes, duke njoftuar edhe palët për vendimin. Në këtë kuptim, për sa i përket kërkesës së parë procedurale, Gjykata vëren se kërkesa e Kryetares për *amicus curiae* drejtuar Komisionit të Venecias më 10.12.2024 është bërë në kuadër të ushtrimit të funksionit dhe kompetencave të saj si Kryetare dhe jo për qëllime të shqyrtimit të një çështjeje konkrete nga kjo Gjykatë. Për rrjedhojë, ajo nuk passjell, sipas ligjit, pezullimin e shqyrtimit të çështjes konkrete. Prandaj Gjykata vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë.

9. Për sa i përket kërkesës së dytë procedurale, asaj që vetë Gjykata, për qëllime të këtij gjykimi, t'i drejtohet Komisionit të Venecias për marrjen e një *amicus curiae*, bazuar në natyrën e çështjes në shqyrtim ashtu edhe përmbajtjen e dispozitave ligjore të mësipërme, u vlerësua se ajo nuk mbart nevojën për marrjen e një opinioni këshillimor në lidhje me çështje parimore të lidhura me interpretimin ose zbatimin e të drejtave apo parimeve e standardeve ndërkombëtare. Prandaj Gjykata vendosi rrëzimin edhe të kësaj kërkesë¹.

10. Ndërsa në lidhje me kërkesën e tretë që ka të bëjë me pezullimin e zbatimit të aktit “Njoftim” të kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe procedurave të bazuara/inicuar mbi atë akt, Gjykata, duke pasur parasysh natyrën dhe shkaqet e saj, vendosi ta shqyrtojë bashkë me themelin e çështjes.

II

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

11. Gjykata vëren se nisur nga rrethanat e çështjes, si dhe duke mbajtur në konsideratë se pas reformës kushtetuese të vitit 2016, që ndryshoi edhe disa nga dispozitat kushtetuese, në lidhje me përbërjen dhe ripërtëritjen e Gjykatës, ky është rasti i parë kur ajo përballet me përmbajtjen

¹ Gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja dhe Ilir Toska votuan për pranimin e kërkesës.

dhe zbatimin e tyre. Për këtë arsye, paraprakisht Gjykata vlerëson të ndalet në disa *aspekte procedurale* të kësaj vendimmarrjeje.

12. *Së pari*, në lidhje me *kompetencën e Gjykatës* për të vendosur për këtë çështje, ajo është parashikuar në nenin 127, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilit: “*Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese.*”. I njëjti parashikim është edhe në nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000. Këto dispozita nuk kanë pësuar ndryshime, prandaj Gjykata çmon se çështja është në kompetencën e saj.

13. *Së dyti*, në lidhje me *mënyrën e vënies në lëvizje të Gjykatës* për deklarimin e mbarimit të mandatit të një gjyqtari të saj, Kushtetuta nuk ka ndonjë rregull të shprehur, ndërkohë që në nenin 9, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se: “[...] *Kërkesa për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit bëhet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese*”. Nisur nga përmbajtja e kësaj dispozite, Gjykata vlerëson se në rastet e përfundimit të mandatit të një gjyqtari, përfshirë edhe rastin kur gjyqtari është në detyrën e kryetarit, ajo vihet në lëvizje nga ky i fundit. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata çmon se është vënë në lëvizje në mënyrën e parashikuar nga ligji.

14. *Së treti*, në lidhje me *afatin e vendimmarrjes së Gjykatës* për mbarimin e mandatit të një gjyqtari të saj, as Kushtetuta, as ligji nr. 8577/2000 nuk kanë ndonjë parashikim specifik, por, gjithsesi, referuar përcaktimit të bërë në nenin 9, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, që bën fjalë për njoftimin e organit të emërtesës nga Kryetari i Gjykatës në lidhje me përfundimin e mandatit të një gjyqtari jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi normal i mandatit të gjyqtarit dhe menjëherë në rastet e mbarimit të tij përpara afatit ligjor, Gjykata del në përfundimin se është pikërisht ky afati për vendimmarrjen e saj, pra të paktën 3 muaj përpara mbarimit normal të mandatit të gjyqtarit dhe menjëherë në rastet e mbarimit të tij përpara afatit ligjor. Në këtë drejtim vlen të përmendet se duke mbajtur në vëmendje se kohëzgjatja e procedurave për emërimin/zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues pas reformës në drejtësi të vitit 2016 ka kapërcyer afatin 3-mujor të synuar nga ligji pikërisht për shkak të kohës që ka marrë procesi i zhvilluar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës, si dhe renditjen e tyre sipas meritës profesionale, kompetencë kushtetuese kjo që mundëson në vijim ushtrimin nga organi i emërtesës të kompetencës së tij për emërimin/zgjedhjen e gjyqtarit kushtetues, me qëllim përfundimin në kohë të procedurave të kësaj

natyre, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, në nenin 8, pika 5, të Rregullores së saj, si afat për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit ka përcaktuar jo më vonë se 4 muaj nga mbarimi i tij. Gjithsesi, është e nevojshme që ligjvënësi të konsiderojë problematikat e lindura në praktikë në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave për emërimin/zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues, me qëllim përcaktimin e afateve realiste për disiplinimin e këtij procesi në tërësi.

15. Në rastin në shqyrtim duket se ka dy qëndrime për momentin e mbarimit të mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj, njëri i Kryetares së Gjykatës se mandati i saj si gjyqtare mbaron në 31.12.2025, tjetri i kryetarit të Gjykatës së Lartë, në cilësinë e kryetarit të organit të emërtesës, në njoftimin e datës 11.12.2024 se mandati i gjyqtarës në fjalë mbaron në datën 10.03.2025. Referuar qëndrimit të parë duket se nuk ka ndonjë problematikë në lidhje me respektimin e afatit të vendimmarrjes. Ndërsa referuar qëndrimit të dytë duket se Gjykata është në vonesë disaditore. Gjithsesi, duke mbajtur në konsideratë dhe situatën e krijuar, Gjykata vlerëson se afati ligjor “jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi normal i mandatit” për vendimmarrjen e saj nuk mund të përbëjë pengesë dhe as shkak për të mos ushtruar apo për të shuar kompetencën e Gjykatës për deklarimin e mbarimit të mandatit të një gjyqtari të saj, për sa kohë mandati dhe kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë përbëjnë garanci për pavarësinë dhe legjitimitetin e gjyqtarit dhe, për rrjedhojë, edhe të vetë Gjykatës. Prandaj, Gjykata vlerëson se është në kushtet kur duhet të marrë një vendim në lidhje me mbarimin e mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj, pavarësisht datës kur mbaron mandati i saj në vitin 2025.

16. Gjithashtu, duke marrë shkas nga situata e krijuar, me qëllim shmangien e konfliktit me organin e emërtesës në lidhje me mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues, për të siguruar pavarësinë dhe legjitimitetin e tij sikundër edhe të Gjykatës, nga njëra anë, por edhe për të garantuar ushtrimin nga organi i emërtesës së kompetencës së tij për zgjedhjen/emërimin e gjyqtarit kushtetues, nga ana tjetër, Gjykata vlerëson të ndalet dhe të analizojë procedurën që duhet të ndiqet në rastin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues.

17. Në këtë drejtim, bazuar në faktet që janë verifikuar gjatë këtij gjykimi, Gjykata konstaton se me njoftimin e datës 11.12.2024 kryetari i Gjykatës së Lartë ka njoftuar hapjen e procedurës për zgjedhjen nga Gjykata e Lartë të anëtarit të ri të Gjykatës Kushtetuese me mandat të plotë 9-vjeçar, duke vlerësuar se sipas nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, gjyqtarja Holta Zaçaj

do të qëndronte në detyrë deri në mars të vitit 2025. Sipas kryetarit të Gjykatës së Lartë ai ka vendosur të hapë këtë procedurë: *“duke iu referuar bazës kushtetuese e ligjore, si dhe faktit se deri sot, datë 11.12.2024, nuk është përmbushur nga Gjykata Kushtetuese as detyrimi për deklarimin e mbarimit të mandatit të znj. Holta Zaçaj, as njoftimi nga Kryetari i Gjykatës për përfundimin e mbarimit të mandatit, me qëllim kryerjen nga Gjykata e Lartë, brenda afatit ligjor, të hapjes së procedurës së aplikimit për anëtar të Gjykatës Kushtetuese; ndodhur në kushtet kur: [...] koha e përfundimit në mars 2025 të mandatit të gjyqtarit zëvendësues Holta Zaçaj është e bazuar në nenin 179, pika 3, të Kushtetutës, në të gjithë procedurën ligjore që është ndjekur [...]; mosvënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetues nga Kryetari i saj për të shpallur jo më vonë se data 10.12.2014 mbarimin e mandatit të znj. Holta Zaçaj, nuk mund të pengojë dhe as të shmangë ushtrimin nga Gjykata e Lartë dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi të kompetencës kushtetuese për zgjedhjen e anëtarit të ri të Gjykatës Kushtetuese [...]”*.

18. Gjykata vlerëson të theksojë, fillimisht, se parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe fryma e Kushtetutës pranojnë bashkëpunim dhe bashkëveprim ndërmjet tyre (shih vendimin nr.10, datë 06.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Ndonëse Kushtetuta nuk e përmban në mënyrë të shprehur parimin e luajalitetit kushtetues, ky parim shpreh, në thelb, respektin e ndërsjellë nga secili subjekt ndaj kompetencave të tjetrit, si dhe nënkupton krijimin e një raporti bashkëpunimi midis tyre. Ai shpreh nevojën e krijimit të një modeli qeverisjeje ku mekanizmat veprojnë në mënyrë eficiente, pasi një model i tillë, me detyrimin që cakton ndaj organeve, e bën Kushtetutën funksionale. Parimi i luajalitetit kushtetues përfshin edhe detyrimin për sjellje koherente dhe jokontradiktore, pra palët nuk duhet të kenë qëndrime zvarritëse, bllokuese, të paqarta ose të pajustificuara, në mënyrë që bashkëpunimi midis tyre të jetë mbi baza mirëbesimi dhe korrektësi, si dhe të jenë të hapura për qasjet e ndryshme të palës tjetër, por gjithnjë duke respektuar kompetencat që i janë dhënë secilës palë (shih vendimin nr. 26, datë 25.05.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

19. Mbi bazën e këtij parimi dhe duke mbajtur në konsideratë përmbajtjen e dispozitave kushtetuese dhe atyre ligjore, Gjykata thekson se hapja e procedurës për plotësimin e një vendi vakant duhet të fillojë vetëm pasi kjo Gjykatë të ketë deklaruar mbarimin e mandatit të anëtarit të saj, sipas nenit 127, pika 2, të Kushtetutës dhe vetëm pasi Kryetari i saj të ketë njoftuar organin

përkatës të emërtesës sipas nenit 9, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000. Për rrjedhojë, në çdo rast kur një organ i emërtesës vlerëson se Gjykata nuk e ka ushtruar kompetencën e saj brenda afatit ligjor, ai duhet t'i drejtohet Gjykatës, duke i kërkuar me shkrim ushtrimin e një kompetence të tillë, si dhe duke parashtruar, në çdo rast, edhe argumentet përkatëse në drejtim të fakteve dhe dispozitave kushtetuese në të cilat mbështet qëndrimin e tij për mbarimin e mandatit të gjyqtarit për pozicionin e të cilit është organ emërtesë sipas Kushtetutës dhe ligjit. Në këtë rast, Gjykata, pa vonesë, duhet të shprehet me vendim, i cili është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim. Kjo është mënyra e vetme e të vepruarit të organeve kushtetuese të përfshira në procedurën e emërimit/zgjedhjes të gjyqtarit kushtetues, bazuar jo vetëm në parimin e luajalitetit kushtetues, por që garanton ushtrimin pa pengesa të kompetencave kushtetuese dhe ligjore nga çdo organ dhe, çka është më e rëndësishme, parimin e pavarësisë së kësaj Gjykate.

20. Për sa i përket *themelit të çështjes* Gjykata vlerëson se çështja e mbarimit të mandatit të gjyqtares Holta Zaçaj lidhet me atë çka kanë përcaktuar për këtë aspekt Kushtetuta, ligji nr. 8577/2000 dhe aktet e procedurës së zgjedhjes së saj.

21. Në këtë kuptim, referuar procedurës së zgjedhjes së gjyqtares Holta Zaçaj, rezulton se ajo është bazuar në nenin 125, pika 1 dhe 179, pika 3, të Kushtetutës, ku i pari rregullon përbërjen e Gjykatës, kompetencën e emërimit/zgjedhjes së gjyqtarit kushtetues dhe shpërndarjen e saj mes 3 organeve të emërtesës, ndërsa i dyti është dispozitë kalimtare që përmban rregullime për mënyrën e përtëritjes së rregullt të përbërjes së Gjykatës në periudhën pas ndryshimeve kushtetuese sipas ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016. Po ashtu, ajo procedurë është bazuar edhe në nenet 7/ç dhe 7/dh të ligjit nr. 8577/2000, që rregullojnë respektivisht procedurën e zgjedhjes së gjyqtarit kushtetues nga Gjykata e Lartë (si organi i emërtesës në rastin konkret) dhe përtëritjen e përbërjes së Gjykatës.

22. Nisur nga sa më lart, në funksion të përcaktimit të datës së mbarimit të mandatit të gjyqtares Holta Zaçaj, Gjykata do të analizojë në vijim përmbajtjen e normave kushtetuese dhe ligjore të zbatuara dhe ato të lidhura me to, sikundër edhe procedurën e ndjekur për zgjedhjen e kësaj gjyqtareje.

23. Në këtë kuptim vërehet se ajo ka aplikuar si kandidate në procedurën e shpallur nga Gjykata e Lartë për plotësimin e vendit vakant të krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të

gjqtares Vitore Tusha në datën 10.03.2017, i deklaruar me vendimin nr. 19, datë 10.03.2017 të Gjykatës. Neni 179 i Kushtetutës, i të shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, në pikën 3 të tij parashikon: *“Me qëllim përtëritjen e rregullt të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2025 dhe gjyqtari i ri, që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2020, do të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2028, ndërsa gjyqtarët e tjerë të Gjykatës Kushtetuese emërohen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit, sipas ligjit”*. Pra, duke iu referuar kësaj dispozite dhe të dhënave të faktit, rezulton se gjyqtarja Holta Zaçaj ka zëvendësuar gjyqtaren Vitore Tusha. Kjo dispozitë, në ndryshim nga neni 125, pika 7, i Kushtetutës, që parashikon se gjyqtari kushtetues vazhdon në detyrë deri në zgjedhjen e pasardhësit të tij, nuk flet për gjyqtarë pasardhës, por për gjyqtarin që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017.

24. Sikurse është përmendur edhe më sipër (*shih paragrafin 11 të vendimit*), pas reformës kushtetuese të vitit 2016, ky është rasti i parë kur Gjykata, në ushtrim të kompetencës së saj për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit, përballlet me parashikimin e bërë në dispozitën kalimtare, konkretisht nenin 179, pika 3, të Kushtetutës. Ndërkohë, i njëjti parashikim gjendet edhe në nenin 86, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, i shtuar me ligjin nr. 99/2016, i cili ka rregulluar skemën e ripërtëritjes së përbërjes së Gjykatës, duke parashikuar, ndër të tjera: *“Përtëritja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese deri në vitin 2022 do të bëhet sipas skemës së parashikuar më poshtë: a) Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati në vitin 2016, emërohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës dhe nga Kuvendi. b) Gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017, zgjidhet nga Gjykata e Lartë dhe qëndron në detyrë deri në vitin 2025.”*

25. Gjykata vëren se çështja konkrete lidhet me garantimin e përtëritjes së rregullt të përbërjes së Gjykatës pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, duke pasur parasysh për këtë procedurën e ndjekur nga Gjykata e Lartë si organ emërtese, e cila ka përfunduar me zgjedhjen e gjyqtares Holta Zaçaj. Konkretisht, sipas akteve të njoftimit të vakancës nga organi i emërtesës - Gjykata e Lartë, rezulton se kjo vakancë është shpallur dhe rishpallur në datat 16.01.2017, 19.04.2019, 03.06.2021, 31.01.2022 dhe 28.10.2022. Referuar këtyre akteve rezulton se me shpalljen e datës 03.06.2021 është njoftuar shpallja e tre vendeve vakante, ku në vendin vakant që

krijohet pas largimit të znj. Vitore Tusha “*mandati i plotë 9-vjeçar i së cilës ka mbaruar në vitin 2017, zgjidhet gjyqtari i ri që qëndron në detyrë deri në mars 2025*”. Edhe sipas njoftimit për rihapjen e procedurës së aplikimit të datës 31.01.2022 të kryetarit të Gjykatës së Lartë rezulton se është rishpallur “*thirrja për plotësimin e vendit vakant të krijuar nga mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, për pjesën e mbetur të mandatit 9-vjeçar, që përfundon në muajin mars 2025*”. Gjykata e Lartë në këto akte i është referuar nenit 179, pika 3, të Kushtetutës. Nga ana tjetër, edhe vetë gjyqtarja Holta Zaçaj, në kërkesën e saj për aplikim dhe në konfirmimin e kandidaturës pas rishpalljes së kësaj vakance, ka shprehur vullnetin e saj për të kandiduar për plotësimin e vendit vakant të krijuar nga mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, për pjesën e mbetur të mandatit që përfundon në muajin mars të vitit 2025. Në përfundim të kësaj procedure, Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 2, datë 16.01.2023, ka vendosur: “*Zgjedhjen e znj. Holta Zaçaj anëtare të Gjykatës Kushtetuese me mandat të pjesshëm, deri në kryerjen e ripërtëritjes në vitin 2025.*”.

26. Nga sa më sipër, për sa i takon përcaktimit të momentit të mbarimit të mandatit të gjyqtares Holta Zaçaj, rezulton se Kushtetuta ka përcaktuar në mënyrë të qartë vitin e përfundimit të mandatit, konkretisht vitin 2025, por jo ditën dhe muajin e këtij momenti. Prandaj, Gjykata çmon se duhet përcaktuar dita dhe muaji i vitit 2025 në të cilin përfundon mandati i gjyqtares Holta Zaçaj. Në këtë drejtim, sikurse u përmend më sipër (*shih paragrafin 15 të vendimit*), duket se ka dy qëndrime, njëri i Kryetares së Gjykatës se mandati i saj si gjyqtare mbaron në datën 31.12.2025, ndërsa tjetri i kryetarit të organit të emërtesës (Gjykatës së Lartë) se mandati i gjyqtares mbaron në datën 10.03.2025.

27. Për sa i përket mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, Gjykata mban në konsideratë se Kushtetuta ka parashikuar si datë të fillimit të detyrës betimin përpara Presidentit të Republikës (neni 129), kurse neni 8, pika 3, i ligjit nr. 8577/2000, ndërsa përmban të njëjtin parashikim për fillimin e mandatit, përcakton se mbarimi i tij është në datën e njëjtë të atij muaji të vitit të nëntë, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Ndërkohë që për sa i përket datës së saktë të përfundimit të qëndrimit në detyrë të gjyqtares Holta Zaçaj, Gjykata vëren se qëndrimi në detyrë dhe kohëzgjatja e mandatit të saj ka të bëjë me kuptimin e nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, të normave të tjera kushtetuese, për aq sa ato lidhen me të, të normave të ligjit nr.

8577/2000 të Gjykatës, si dhe të akteve të procedurës së zgjedhjes së saj. Për rrjedhojë, në rastin konkret mandati kushtetues është kufizuar nga vetë norma kushtetuese (dispozita kalimtare), e cila ka parashikim të ndryshëm nga rregulli i përgjithshëm i kohëqëndrimit në detyrë dhe mbarimit të mandatit.

28. Gjykata vlerëson se normat kushtetuese që parashikojnë fillimin dhe mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues të lidhur me datën e betimit të tij përpara Presidentit kanë të bëjnë me parimin e pavarësisë së Gjykatës. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre. Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet. Vetëm një gjykatë e pavarur, së cilës i garantohet paprekshmëria e mandatit të anëtarëve të saj, mund të konsiderohet si një gjykatë që administron drejtësinë kushtetuese, në përputhje me parimet kushtetuese. Edhe pse mandati i gjyqtarit kushtetues ka kuptimin e një mandati të dhënë (jo të fituar nëpërmjet votës së zgjedhësve aktivë), parimi i pavarësisë nënkupton, gjithashtu, se gjyqtari, në momentin e emërimit, duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë (*shih vendimet nr. 55, datë 27.07.2016; nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Ndërkohë, referuar përmbajtjes së nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, që është norma që gjen zbatim në rastin në shqyrtim, duhet theksuar se bëhet fjalë për situatë kalimtare, qëllimi i së cilës është garantimi i përtëritjes së rregullt të përbërjes së Gjykatës. Në jurisprudencën e Gjykatës parashikimi kushtetues që ka vendosur rregullin/sistemin e përtëritjes periodike dhe të pjesshme të përbërjes së Gjykatës është vlerësuar se garanton vazhdimësinë e jurisprudencës dhe kombinimin e përvojës së Gjykatës, duke qenë po ashtu mjet për garantimin e pavarësisë së saj, për sa kohë mandati i gjyqtarëve nuk përplasat me kohëzgjatjen e mandatit presidencial dhe atë parlamentar, por i tejkalon ato. Gjykata ka theksuar se ky rregull përbën një parim organizativ, i cili bazohet pikërisht në veçoritë specifike të procesit kushtetues, që përveç njohurive të gjyqtarëve, kërkon dhe përvojën e duhur. Ky rregullim ka për qëllim ruajtjen në përbërje të Gjykatës të një shumice prej dy të tretave të anëtarëve me stazh në detyrë, çka bën të mundur

krijimin e një përvoje juridike të posaçme dhe të specializuar në gjykimin kushtetues, e cila nuk mund të përftohet askund tjetër. Kjo bazë njohurish tekniko-juridike në fushën e gjykimit kushtetues, duke qenë se ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e vendimmarrjes, konsiderohet nga Gjykata si një vlerë e mbrojtur nga Kushtetuta. Respektimi dhe zbatimi i parashikimit kushtetues të përtëritjes së përbërjes së saj çdo tre vjet, në një të tretën e anëtarësisë, paraqet rëndësi të veçantë në kuptim të ruajtjes dhe forcimit të pavarësisë dhe vazhdimësisë së këtij organi (*shih vendimin nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Bazuar në këtë premisë, për zgjidhjen e çështjes janë të zbatueshme dy parime kushtetuese, nga njëra anë, *parimi i pavarësisë së gjyqtarit në aspektin e patundshmërisë në detyrë*, dhe, nga ana tjetër, *parimi i përtëritjes periodike dhe të pjesshme të përbërjes së Gjykatës*, që lidhet jo vetëm me funksionimin e drejtë të saj në pikëpamje të vazhdimësisë së jurisprudencës dhe kombinimit të përvojës së saj, por edhe me respektimin e parimit të balancës dhe kontrollit midis pushteteve në një shtet demokratik, parime të cilat në pamje të parë duket se ndeshen me njëra-tjetrën në rastin konkret. Prandaj, për të gjetur ekuilibrin e duhur midis këtyre dy parimeve, Gjykata vlerëson se duhet të mbahen parasysh arsyet që çuan ligjbërësin kushtetues për miratimin e nenit 179, pika 3, të Kushtetutës. Për këtë qëllim, në vijim, ajo do të ndalet në analizën e kësaj dispozite dhe të termave të saj, duke theksuar se ato duhet të lexohen në harmoni me normat e tjera kushtetuese relevante. Sikurse ka pohuar Gjykata, interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është funksioni më i rëndësishëm i saj, të cilin ajo e ushtron sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese. Kontrolli kushtetues, në çdo rast, nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim (*shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për sa u përket arsyeve të miratimit të nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, Gjykata vëren se referuar materialeve në lidhje me reformën kushtetuese në drejtësi, por edhe opinionit të Komisionit të Venecias për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*shih opinionin CDL-AD (2020)010*), duket se ato kanë pasur të bëjnë me gjetjen e një mekanizmi për të mundësuar zbatimin e parimit kushtetues të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës, por edhe për të bërë funksionale kompetencën e organeve të emërtesës sipas modelit të ri të emërimit/zgjedhjes së

gjqtarëve, duke parashikuar mënyrën e zbatimit të këtij parimi në të ardhmen në raport me situatën faktike të përbërjes së Gjykatës në atë moment për sa i përket mbarimit të mandateve të gjyqtarëve të saj, situatë e cila, për shkak të një konflikti të organeve të mëparshme të emërtesës (President/Kuvend), kishte çuar në mosrespektimin e këtij parimi kushtetues. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se është në kompetencë të ligjvënësit kushtetues që të gjejë dhe të zbatojë mekanizmin e përshtatshëm për të respektuar parimin kushtetues të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës çdo tre vjet në një të tretën e saj (*shih vendimin nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Ndaj në vlerësimin e Gjykatës kjo dispozitë, sikurse ajo shprehet se ka për qëllim përtëritjen e rregullt të përbërjes së saj, ka parashikuar specifikisht kufizimin e qëndrimit në detyrë të dy gjyqtarëve, të cilët do të zëvendësonin gjyqtarët që, për shkak të kohës së emërimit, mandati nuk u përfundonte në vitet 2016 dhe 2019, por një vit më pas dhe, konkretisht, në vitet 2017 dhe 2020, për të përputhur në këtë mënyrë situatën faktike me rregullin kushtetues të përtëritjes së rregullt të përbërjes së Gjykatës. Në përputhje me këtë linjë arsyetimi, pas dhënies së opinionit të Komisionit të Venecias për projektligjin për ndryshimet kushtetuese (*shih opinionin CDL(2016)02, paragrafi 81*), në tekstin e nenit 179, pika 3, të Kushtetutës u shtua togfjalëshi “*me qëllim përtëritjen e rregullt të përbërjes së Gjykatës*”.

33. Në vijim të kësaj analize duket se me shtimin e këtij togfjalëshi në përmbajtje të dispozitës kalimtare, kushtetutëbërësi në ekuilibrin midis parimit të qëndrueshmërisë në detyrë dhe atij të përtëritjes së Gjykatës, i ka kushtuar vëmendje të veçantë këtij të fundit. Nga ana tjetër, për sa i takon datën e përfundimit të mandatit, edhe pse neni 129 i Kushtetutës i lidhur me nenin 8, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000 referon te momenti i betimit, në rastin konkret data dhe muaji i mbarimit të mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj nuk mund të lidhet me datën e betimit të saj (25 janar). Një interpretim i tillë do të binte ndesh me parimin e pavarësisë, në kuptim të sigurisë juridike, sipas të cilit gjyqtari kushtetues, në momentin e emërimit, duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati (*shih paragrafin 28 të vendimit*), pasi aktet që lidhen me procedurën e ndjekur nga Gjykata e Lartë për emërimin e saj i janë referuar muajit mars të vitit 2025.

34. Bazuar në sa më sipër, nën logjikën e zbatimit të parimit kushtetues të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës, momenti i mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës (zonjës Vitore

Tusha) duket se ka lidhje me kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë të gjyqtarit që e ka zëvendësuar atë (zonjës Holta Zaçaj), në veçanti për sa i përket momentit të mbarimit të kësaj kohëzgjatjeje. Ligjbërësi kushtetues dhe, në vijim, ligjvënësi, përmes asaj dispozite kushtetuese kalimtare dhe atyre rregullimeve të bëra në ligjin nr. 8577/2000, duket se e kanë përcaktuar kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë të gjyqtarit zëvendësues të lidhur jo thjesht me vitin 2025, por edhe me momentin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës, që në rastin konkret është data 10 mars. Në këtë kuptim, në respektim rigoroz të Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000, zgjedhja/emërimi i gjyqtarit që do të zëvendësonte zonjën Vitore Tusha do të duhej të përfundonte jo më vonë se data 10.03.2017, datë brenda së cilës, gjithashtu, gjyqtari i ri duhet të kishte bërë edhe betimin, pasi vetëm në këtë mënyrë bëhej i mundur respektimi i kohëzgjatjes së qëndrimit në detyrë të gjyqtarit të ri sipas përcaktimit të bërë në dispozitën kushtetuese kalimtare. Pikërisht kjo lidhje mes mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës dhe fillimit (ideal) të qëndrimit në detyrë të gjyqtarit të ri, duket se është pasur në konsideratë nga ligjbërësi kushtetues në dispozitën kushtetuese kalimtare, sikundër në vijim edhe nga ligjvënësi në veçanti për sa u përket ndryshimeve të bëra në nenin 86 të ligjit nr. 8577/2000, në lidhje me kohën e qëndrimit në detyrë të gjyqtarit të ri në funksion të zbatimit të parimit kushtetues të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës.

35. Nga ana tjetër, duket se në të njëjtën mënyrë është kuptuar dhe zbatuar norma kushtetuese edhe në procedurën e ndjekur për plotësimin e vendit vakant të krijuar nga mbarimi i mandatit të zonjës Vitore Tusha. Edhe në këtë drejtim, Gjykata konstaton se jo vetëm që në aktet e njoftimit të vakancës, organi i emërtesës, Gjykata e Lartë, ka specifikuar kohën e qëndrimit në detyrë të gjyqtarit që do të plotësonte vakancën e krijuar nga mbarimi i mandatit të gjyqtarës Vitore Tusha dhe datën e mbarimit të tij, por edhe se gjyqtarja Holta Zaçaj në aktet e kandidimit ka shprehur vullnetin e saj për kohën e mbetur të këtij mandati, sipas shpalljes së vakancës.

36. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kushtetuta dhe ligji nr. 8577/2000, pas reformës së vitit 2016, sikundër edhe aktet e procedurës së zgjedhjes së gjyqtarës Holta Zaçaj, duket se kanë përcaktuar një datë të saktë të përfundimit të qëndrimit në detyrë dhe, për pasojë, edhe të mbarimit të mandatit të saj, pikërisht datën 10.03.2025. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se mbarimi i mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj lidhet me datën e mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ajo ka zëvendësuar, pra datën 10 mars.

37. Së fundmi, për sa i përket kërkesës së tretë procedurale të Kryetares së Gjykatës, për pezullimin e zbatimit të aktit “Njoftim” të kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe procedurave të bazuara/inicuar mbi atë akt, të cilat janë vënë në lëvizje duke u konsideruar si datë e mbarimit të mandatit të gjyqtares Holta Zaçaj data 10.03.2025, duke qenë se Gjykata vendosi që ta shqyrtonte bashkë me themelin e çështjes dhe për sa kohë ajo (Gjykata) arriti në të njëjtin përfundim në lidhje me datën e mbarimit të mandatit të kësaj gjyqtareje, vlerëson se vendimi i saj nuk ndikon procedurën e vënë në lëvizje nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë ajo e gjen të pabazuar edhe këtë kërkesë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 127, pika 2 dhe 179, pika 3, të Kushtetutës, si dhe neneve 8, pika 3, 9, pikat 2 e 3 dhe 86, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese, zonjës Holta Zaçaj, në datën 10.03.2025.
- Njoftimin e Gjykatës së Lartë si organi i emërtesës.
- Njoftimin e Presidentit të Republikës dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë.

Marrë më 23.12.2024

Shpallur më 27.01.2025

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkesës së Kryetares së Gjykatës Kushtetuese me objekt: “*Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese, zonjës Holta Zaçaj*”, edhe pse i bashkohem shumicës në qëndrimin se Gjykata është në kushtet që duhej të merrte vendim në lidhje me këtë kërkesë, për sa kohë që është vetëm kjo Gjykatë organi që ka kompetencën për të marrë një vendim të tillë dhe vetëm pasi vihet në lëvizje nga Kryetari i saj, nuk i bashkohem asaj në lidhje me datën e përfundimit të kohës së qëndrimit në detyrë të gjyqtares Holta Zaçaj, e cila, në vlerësimin tim, është dita e fundit e muajit të fundit të vitit 2025, do të thotë data 31 dhjetor 2025. Në vijim, unë do të parashtoj argumentet ku mbështes këtë qëndrim timin.

2. Së pari, dua të evidentoj se në lidhje me kërkesat procedurale të paraqitura nga gjyqtarja Holta Zaçaj, unë kam votuar pro si për kërkesën për marrjen e një opinionit *amicus curiae* nga Komisioni i Venecies, ashtu edhe për atë lidhur me pezullimin e njoftimit të kryetarit të Gjykatës së Lartë për hapjen e procedurës për zgjedhjen të anëtarit të ri të Gjykatës Kushtetuese, kërkesë që është e lidhur me qëndrimin tim për themelin e çështjes.

3. Vlerësoj të evidentoj më së pari, se neni 127, pika 2, i Kushtetutës sqaron që mbarimi i mandatit të gjyqtarit kushtetues deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Të njëjtin formulim e gjejmë edhe në nenin 9, pika 2, të ligjit organik të Gjykatës. Shumë evidente kompetenca që ka Gjykata kur mblidhet për të shqyrtuar kërkesën e kryetarit të saj: ajo **deklaron** një datë të caktuar kalendarike që u hap rrugën disa procedurave të tjera që nuk mund të nisnin/iniciohen kryesisht pa këtë akt të Gjykatës. Natyra e këtij lloj vendimi, duke qenë tërësisht deklarativ, është formaliste. Të tilla kanë qenë edhe vendimet e kësaj Gjykate ndër vite për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarëve kushtetues, ashtu sikundër edhe ato më të fundit, në rastin e gjyqtarëve Altin Binaj, Përparim Kalo apo Elsa Toska (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2021; nr. 42, datë 22.12.2021 dhe nr. 62, datë 23.09.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Ky gjykim, për nga natyra e tij, zhvillohet pa palë ndërgjyqëse, sepse Kushtetuta dhe ligji kanë vendosur/caktuar sinorët e Gjykatës në nenin 125, pika 3, që thotë: “*Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi*”, dhe nenin 129 të Kushtetutës

që thotë: “Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin përpara Presidentit të Republikës”. Për të mos i lënë ndonjë diskrecion Gjykatës dhe vetë gjyqtarëve në ushtrimin e kësaj kompetence, ligjvënësi ka përcaktuar edhe formulën e llogaritjes së afatit brenda të cilit gjyqtari kushtetues ka të drejtë të ushtrojë detyrën kushtetuese. Pika 1 e nenit 8 të ligjit organik të Gjykatës thotë: “Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit të Republikës së Shqipërisë.”, dhe pika 3 e të njëjtit nen thotë: “Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese fillon nga data e betimit dhe mbaron në datën e njëjtë të atij muaji të vitit të nëntë, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.”.

5. Njohja dhe ushtrimi i një kompetence të tillë lidhet me disa garanci dhe parime kushtetuese, ndër të tjera ai i pavarësisë së Gjykatës ashtu sikundër ai i patundshmërisë në detyrë të gjyqtarit kushtetues, ndaj Kushtetuta dhe ligji kërkojnë që deklarimi i përfundimit të qëndrimit në detyrë të një gjyqtari kushtetues të bëhet veçse me vendim të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim garantimin e kësaj pavarësie dhe për të mos lejuar apo edhe ndaluar që mandati i një gjyqtari të interpretohet/kufizohet/ndërpritet/ndryshohet nga ndonjë organ tjetër. Në lidhje me aspektet procedurale të procedurës, ndërsa Gjykata vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të Kryetarit të saj, siç ndodhi edhe konkretisht, pra as kryesisht, as me kërkesë të ndonjë organi tjetër, as sepse u konstatua një qëndrim ndryshe i përfaqësuesit të një organi tjetër (kryetarit të Gjykatës së Lartë), gjykimi është kameral, pa palë, dhe si akte të gjykimit administrohen kërkesa e Kryetarit dhe aktet e zgjedhjes/emërimit të gjyqtarit për të cilin kërkohet të deklarohet data e mbarimit të detyrës. Kjo rrjedh qartë nga parashikimet kushtetuese e ligjore që kam cituar më sipër, ndërsa kjo është edhe mënyra se si është proceduar në praktikën institucionale të vetë kësaj Gjykate.

6. Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese e vuri në lëvizje këtë të fundit për të deklaruar se cila është data kalendarike në të cilën i mbaronte asaj vetë koha e qëndrimit në detyrë si gjyqtare kushtetuese në situatën që ajo ishte duke ushtruar një mandat me kohë të kufizuar sipas nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, duke pretenduar se kjo datë është 31 dhjetori 2025 e duke parashtruar argumentet e saj mbi këtë qëndrim. Jo vetëm nisur nga objekti dhe shkaqet e kërkesës, por edhe referuar natyrës së këtij gjykimi, në themel të tij është përlllogaritja, sipas një formule të mirëpërcaktuar, e një date kalendarike të mbarimit të një periudhe kohore që fillon ditën e betimit të gjyqtarit përpara Presidentit, ndërsa përfundon në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të nëntë.

Ky është **rregulli i vetëm** i zbatueshëm, i cili nuk zbatohet vetëm nëse Kushtetuta ka parashikuar qoftë një rregullim të ndryshëm të posaçëm, qoftë një datë të ndryshme për mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues. Si i tillë, këtij lloj gjykimi i mungon debati gjyqësor dhe shqyrtimi gjyqësor mbi çështje që dalin tej këtij gjykimi, që nuk janë objekt kërkese apo mbi fakte ose ngjarje të tjera juridike që nuk lidhen me momentin e fillimit apo mbarimit të mandatit të gjyqtarit.

7. Në përmbledhje të sa më sipër, theksoj se kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e kërkesave të tilla Gjykata thjesht konstaton: i) nëse gjyqtari është zgjedhur/emëruar me mandat të plotë ose të pjesshëm, bazuar në përcaktimin e vakancës në aktin e emërimit/zgjedhjes nga organi i emërtesës apo dekreti presidencial; ii) nëse zbatohet rregulli i përgjithshëm i nenit 129 të Kushtetutës dhe nenit 8, pika 3, të ligjit organik apo nëse ka një rregullim të ndryshëm nga vetë norma kushtetuese, siç është rasti konkret, ku objekt shqyrtimi është vetëm neni 179, pika 3, i Kushtetutës.

8. Në rastin konkret qartësisht nuk jemi përpara rregullimeve të përgjithshme të nenit 125, pika 3, të Kushtetutës, sepse gjen zbatim neni 179, pika 3, i Kushtetutës, do të thotë se kjo gjyqtare është zgjedhur për një mandat të kufizuar, do të thotë se koha e qëndrimit të saj nuk është 9 vjet, çka më tej do të thotë se nuk mund të jetë i zbatueshëm as neni 8, pika 3, i ligjit organik. Konstatuar kjo, më tej konstatohet se neni 179, pika 3, i Kushtetutës ka përcaktuar si afat fundor të kohës së qëndrimit në detyrë vetëm vitin 2025, por nuk ka përcaktuar muajin dhe datën e mbarimit të afatit.

9. Jam dakord me shumicën, sa parashtruar prej saj, se ky është rasti i parë kur ajo përballet me parashikimin e bërë në dispozitën kalimtare, nenin 179, pika 3, të Kushtetutës, ndërsa nuk jam dakord me analizën që i ka bërë shumica kësaj dispozite, analizë e cila ka dalë tej shkaqeve të objektit të kërkesës dhe tej shkaqeve të këtij lloj gjykimi. Koncepti i **përtëritjes së rregullt** në dispozitën kushtetuese kalimtare (neni 179, pika 3) është barazuar nga shumica me rregullin/sistemin e **përtëritjes periodike dhe të pjesshme** duke parashtruar ajo jurisprudencën kushtetuese për këtë të fundit dhe duke dalë në përfundimin vijues se për zgjidhjen e çështjes “*janë të zbatueshme dy parime kushtetuese, nga njëra anë, parimi i pavarësisë së gjyqtarit në aspektin e patundshmërisë në detyrë, dhe, nga ana tjetër, parimi i përtëritjes periodike dhe të pjesshme të përbërjes së Gjykatës, që lidhet jo vetëm me funksionimin e drejtë të saj në pikëpamje të vazhdimësisë së jurisprudencës dhe kombinimit të përvojës së saj, por edhe me respektimin e*

parimit të balancës dhe kontrollit midis pushteteve në një shtet demokratik, parime të cilat në pamje të parë duket se ndeshen me njëra-tjetrën në rastin konkret. Prandaj, për të gjetur ekuilibrin e duhur midis këtyre dy parimeve, Gjykata vlerëson se duhet të mbahen parasysh arsyet që çuan ligjbërësin kushtetues për miratimin e nenit 179, pika 3, të Kushtetutës. Për këtë qëllim, në vijim, ajo do të ndalet në analizën e kësaj dispozite dhe të termave të saj, duke theksuar se ato duhet të lexohen në harmoni me normat e tjera kushtetuese relevante. Sikurse ka pohuar Gjykata, interpretimi përfundimtar i ligjit themelor të shtetit është funksioni më i rëndësishëm i saj, të cilin ajo e ushtron sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese. Kontrolli kushtetues, në çdo rast, nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim” (shih paragrafin 30 të vendimit).

10. Vlerësoj të theksoj në këtë pikë se është tërësisht i gabuar arsyetimi i shumicës së Gjykata bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese. Kjo nuk del as nga dispozitat kushtetuese, as nga qëndrimi i kësaj Gjykate ndër vite kur ajo është ndalur në ushtrimin e kësaj kompetence për të zgjidhur një çështje konkrete të shtruar për zgjidhje në një gjykim me palë ndërgjyqëse, të cilave u është kërkuar dhe kanë shprehur qëndrimet e tyre, duke debatuar me njëra-tjetrën për të mbrojtur secila të drejtën që i është kërkuar Gjykatës të rivendosë dhe që është pretenduar se ia ka marrë ose nuk ia ka dhënë ose ia ka shkelur pala tjetër. Një procedurë thjesht deklarative si kjo që ushtron Gjykata sipas nenit 127, pika 2, të Kushtetutës në rastin e parashikimit të nenit 179, pika 3, të Kushtetutës nuk e legjitimon atë të ushtrojë këtë funksion (interpretativ) sepse është në pamundësitë e krijimit të ndonjë premise apo situatë konkrete që do të kërkonte interpretim të normave kushtetuese në këtë nivel dhe formë. Dëshiroj të kujtoj dhe sjell në vëmendje që ka pasur raste kjo Gjykatë (në rastin e deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtarit Përparim Kalo) ku gjyqtari iu drejtua Gjykatës në mënyrë të shprehur me kërkesë për interpretim të dispozitave që kanë të bëjnë me mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues, duke pretenduar, në thelb, se mandati plotësues, siç ishte rasti i mandatit të atij gjyqtari, përcaktuar si i tillë edhe në dekretin e Presidentit, duhet të llogaritet bazuar në ushtrimin efektiv të tij (mandatit). Gjykata e citoi në vendim këtë kërkesë të gjyqtarit (shih paragrafin 7 të vendimit

nr. 42, datë 22.12.2021) por nuk e shqyrtoi dhe nuk dha asnjë koment ose vlerësim ose trajtim mbi të duke e konsideruar kërkimin tej kompetencave të saj, qasje e cila duhej të ishte mbajtur edhe në rastin në shqyrtim.

11. Për më tepër, theksoj të sqaroj dhe evidentoj se as në kërkesën e Kryetares së Gjykatës, që ka vënë në lëvizje gjykimin në fjalë, nuk është kërkuar interpretimi i normave kushtetuese (nenit 179, pika 3), por zbatimi i tyre në përputhje me frymën e Kushtetutës për përcaktimin e një date konkrete kalendarike sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës, kjo në mungesë të vetë parashikimit kushtetues/formulës kushtetuese në lidhje me këtë mandat specifik. Interpretimi i shumicës ka dalë tej objektit të kërkesës, tej shkaqeve të saj, tej natyrës së gjykimit duke iu referuar një standardi dhe jurisprudence që as i përket përmbajtjes së nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, dhe një formule kushtetuese dhe skeme përtëritje që nuk është objekt gjykimi dhe as e zbatueshme në këtë çështje.

12. Nga ana tjetër, gjej të gabuar dhe jo në kontekst, po aq sa të pavend, edhe referimin në parashikimin e nenit 86, pika 4, të ligjit organik ku, në mënyrë të gabuar, shumica referon për të mbështetur qëndrimin se edhe në këtë normë bazohet lidhja mes mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës dhe fillimit (ideal) të qëndrimit në detyrë të gjyqtarit të ri (*shih paragrafin 34 të vendimit*). Kjo dispozitë kalimtare: *së pari*, synon të përcaktojë rendin e organeve të emërtesës që do të zgjedhin gjyqtarët kushtetues, pra **radhën e emërimeve** nga institucionet e emërtesës – sekuenca; *së dyti*, parashikon zbatimin e kësaj skeme nga këto organe emërtese dhe radhën e veprimit të tyre **deri në vitin 2022**, do të thotë që kjo skemë, pra ky rend (radhë) ka përfunduar efektet. Qartësisht kjo dispozitë është e zbatueshme vetëm në lidhje me përcaktimin e organit të emërtesës për zgjedhjen/emërimin e gjyqtarëve kushtetues, ndërsa ajo tashmë jo vetëm nuk sjell më efekte, as nuk ka, në rastin konkret, ndonjë paqartësi se është Gjykata e Lartë organi i emërtesës në këtë procedurë.

13. Konsideroj me vend të theksoj në këtë pikë se Kushtetuta në përmbajtje dhe frymë nuk njeh një **fillim ideal** të qëndrimit në detyrë të një gjyqtari, qoftë kushtetues apo tjetër. Kushtetuta ka një formulë të vetme, të qartë dhe të përcaktueshme që e lidh qëndrimin në detyrë me fillimin e saj, ndërsa fillimi i detyrës nuk ka një moment ideal, por ka një ngjarje/moment të përcaktuar kohor/kalendarik që është data kur Presidenti thërret gjyqtarin të bëjë betimin. **Gjyqtari fillon**

detyrën pasi bën betimin (neni 129 i Kushtetutës) dhe asnjë interpretim/qasje nuk mund të ndryshojë këtë rregull kushtetues **dhe e mbaron atë pasi ka qëndruar 9 vjet në detyrë** (mandati i plotë). Kjo formulë gjen zbatim qoftë kur i njëjti gjyqtar nis dhe mbaron mandatin e plotë apo ai zëvendësohet në këtë mandat nga një gjyqtar tjetër, i cili futet në një kohëzgjatje mbi të njëjtat rregulla konkrete, dhe nuk zbatohet vetëm nëse Kushtetuta parashikon, në mënyrë të shprehur, një datë të ndryshme për mbarimin e afatit të qëndrimit në detyrë.

14. Mbi premisat sa më sipër, nuk është i saktë përfundimi që ka arritur shumica duke e lidhur mandatin e gjyqtarës Holta Zaçaj me atë të znj. Vitore Tusha. Sipas shumicës, neni 179, pika 3, i Kushtetutës, në ndryshim nga neni 125, pika 7, i Kushtetutës, që parashikon se gjyqtari kushtetues vazhdon në detyrë deri në zgjedhjen e pasardhësit të tij, nuk flet për gjyqtarë pasardhës, por për gjyqtarin që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017 (*shih paragrafin 23 të vendimit*). Theksoj se ky qëndrim duket se përmban një koncept të ri kushtetues që kërkon të sjellë shumica. Kushtetuta njeh vetëm këto koncepte të mandatit: *i plotë*, kur një gjyqtar pason atë paraardhës që ka mbaruar mandatin e plotë; *i pjesshëm* apo *i parakohshëm*, kur një gjyqtar hyn në një mandat të plotë të lënë të pambaruar nga gjyqtari që largohet përpara kohe, pra zëvendësohet. Përdorimi i termit pasardhës apo zëvendësues nuk mund të ndryshojë formulimet kushtetuese dhe kjo sidomos kur qartazi znj. Vitore Tusha e kishte mbaruar mandatin e saj të plotë dhe qëndronte në detyrë në pritje të atij gjyqtari që do ta pasonte jo si zëvendësues por si një gjyqtar që do të fillonte dhe mbaronte mandatin e tij kushtetues, si një mandat i ri (jo zëvendësues), që në këtë rast ishte i pjesshëm jo sepse hynte në mandatin e znj. Vitore Tusha (sipas logjikës së shumicës), por sepse vetë Kushtetuta e ka përcaktuar si të tillë, duke vendosur/caktuar një afat konkret të mbarimit (viti 2025), pra duke parashikuar përjashtimin e zbatimit vetëm në këtë rast konkret/specifik nga rregulli i parashikuar në nenin 125, pika 3 të lidhur me nenin 129 të Kushtetutës (nëntë vite kalendarike nga data e betimit).

15. Theksoj se i takon kushtetutëbërësit dhe vetëm atij, që, në rast se vëren se nuk është arritur qëllimi i tij në miratimin e dispozitave kushtetuese, të marrë masa apo të miratojë mekanizma për të siguruar zbatimin e një modeli të caktuar kushtetues. Në këtë lloj gjykimi, pra në këtë fazë, pra në këtë rast konkret, kjo nuk përbën çështje kushtetuese, nuk përbën lëndë kushtetuese dhe as objekt interpretimi/vlerësimi të Gjykatës.

16. Shumica arsyeton se “*momenti i mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës (znj. Vitore Tusha) duket se ka lidhje me kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë të gjyqtarit që e ka zëvendësuar atë (znj. Holta Zaçaj), në veçanti për sa i përket momentit të mbarimit të kësaj kohëzgjatjeje. Ligjbërësi kushtetues dhe, në vijim, ligjvënësi, përmes asaj dispozite kushtetuese kalimtare dhe atyre rregullimeve të bëra në ligjin nr. 8577/2000, duket se e kanë përcaktuar kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë të gjyqtarit zëvendësues të lidhur jo thjesht me vitin 2025, por edhe me momentin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës, që në rastin konkret është data 10 mars.*” (shih paragrafin 34 të vendimit). Sipas formulimit të bërë nga shumica, znj. Vitore Tusha rezulton të ketë pasur dy mandate radhazi, që nuk është aspak e mundur (ndërsa është e ndaluar) bazuar në përcaktimin kushtetues që thotë se gjyqtari kushtetues qëndron në detyrë vetëm për një mandat të plotë “*pa të drejtë riemërimi*” (neni 125, pika 3, i Kushtetutës). Nga analiza e shumicës rezulton një nonsens i madh juridik në faktin që znj. Vitore Tusha ka qëndruar në detyrë përtej mandatit të saj të vetëm, në një mandat të dytë, e ndaluar kjo kategorisht nga Kushtetuta.

17. Sipas vendimit 19, datë 10.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese për deklarimin e mbarimit të mandatit të znj. Vitore Tusha ajo e ka filluar mandatin në datën 10 mars 2008, ditën që bëri betimin përpara Presidentit të Republikës, dhe e ka mbaruar atë në datën 10 mars 2017, me plotësimin e mandatit 9-vjeçar, kjo në përputhje me nenet 125, pika 3 dhe 129 të Kushtetutës. Pas mbarimit të mandatit, znj. Vitore Tusha vijoi të qëndrojë në detyrë deri në zgjedhjen e gjyqtarit pasues, në përputhje me nenin 125, pika 7, të Kushtetutës, ndërsa vijimi i saj në detyrë nuk përbën ushtrim/fillim të një mandati tjetër (të dytë), pasi kjo, ritheksoj, ndalohet nga neni 125, pika 3, i Kushtetutës. Dispozitat kushtetuese nuk lidhin asnjë mandat pasues me një mandat paraardhës, do të thotë nuk lidhin as mandatin e gjyqtarës Holta Zaçaj me atë të znj. Vitore Tusha. Thënë kjo, është e papranueshme logjika e përdorur për të arritur në përfundimin se data 10 mars është data e fillimit të mandatit të gjyqtarit që ka pasuar në detyrë znj. Vitore Tusha dhe, aq më pak, ajo se gjyqtari pasues (i zgjedhur nga Gjykata e Lartë) na paskërkësh hyrë në një mandat të filluar dhe të pambaruar për sa kohë që ai nuk është një gjyqtar zëvendësues sipas të vetmit koncept kushtetues që parashikon neni 127, pika 3, i Kushtetutës për këtë lloj mandati. Mbarimi i qëndrimit në detyrë të znj. Vitore Tusha nga pikëpamja kushtetuese nuk përbën ndonjë afat apo datë konkrete, specifike, e cila të referohet si një ngjarje juridike nga dispozita kushtetuese me të cilën të lidhet

fillimi apo mbarimi i mandatit të gjyqtarit pasues (Holta Zaçaj). Edhe në referim të përmbajtjes së nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, mandati i gjyqtares Holta Zaçaj nuk është i lidhur me datën e fillimit, për rrjedhojë edhe të mbarimit të mandatit të plotë të znj. Vitore Tusha. Data 10 mars 2017 është ngjarja juridike që ka përcaktuar mbarimin e mandatit të plotë 9-vjeçar të znj. Vitore Tusha sipas normave kushtetuese, ndërsa nuk lidhet, pra nuk përcakton dhe as nuk ka rëndësi kushtetuese dhe ligjore për përlogaritjen e mandatit të gjyqtarit pasues të saj, ndërsa një ngjarje e tillë juridike as nuk përcakton/lidh asnjë mandat pasues kushtetues (me përjashtim të atij zëvendësues dhe vetëm kur është rasti i nenit 127, pika 3, të Kushtetutës). Norma kushtetuese nuk e lidh mandatin e gjyqtares Holta Zaçaj me atë të znj. Vitore Tusha, por e ka cituar vitin e mbarimit të mandatit të kësaj të fundit për të qenë e evidentueshme/e dallueshme/e përcaktueshme se cilit gjyqtar të vetëm/të përcaktuar i kufizohet koha e qëndrimit në detyrë dhe se cilat do të jenë mandatet e vetme të lejuara për t'u konsideruar të kufizuara jashtë përcaktimit të kohëzgjatjes 9 vjet të mandateve të tjera kushtetuese.

18. Në nenin 4, pika 3, të Kushtetutës përcaktohet se dispozitat kushtetuese zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur vetë ajo parashikon ndryshe. Sipas këtij parimi themelor, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, siç vlerësoj të theksoj se ka bërë shumica në rastin konkret. Gjykata ka theksuar se rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese, pasi ajo nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës politiko-shoqërore të një vendi, por vetëm parimet dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të mbështetet (*shih vendimet nr. 55, datë 27.07.2016; nr. 22, datë 24.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla (...) atje ku nuk është shprehur (*shih vendimet nr. 10, datë 26.02.2015; nr. 25, datë 15.12.2008; nr. 212, datë 29.12.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Unë jam e qëndrimit se në referim të këtij standardi, kushtetutëbërësi, ndërsa nuk ka përcaktuar një datë dhe nuk ka lidhur mandatin me një ngjarje/mandat të caktuar jo se ka ometuar, por ka zgjedhur, pra ka dashur të veprojë kështu, me qëllimin për të zbutur në maksimum efektet

e një dispozite kufizuese të një mandati kushtetues. Duke qenë se për shkak të zbatimit të nenit 179, pika 3 një gjyqtari kushtetues i është kufizuar mandati 9-vjeçar, Kushtetuta ka synuar që pasojat e këtij kufizimi (duke konsideruar garanci kushtetuese mandatin e plotë 9-vjeçar) të jenë sa më të vogla në këtë situatë që përbën një rast përjashtimor. Duke pasur këtë qasje, unë jam e qëndrimit se përlllogaritja në këtë rast bëhet bazuar në parimet e përgjithshme të së drejtës që kanë të bëjnë me mënyrën e përlllogaritjes së afateve që nuk janë të përcaktuara në ditë dhe datë të saktë. Edhe vetë vendimi i Mbledhjes së Posaçme të Gjykatës së Lartë (akti i zgjedhjes në detyrë të gjyqtarës Holta Zaçaj në Gjykatën Kushtetuese) në përcaktimin e tij përmban pikërisht formulimin sipas nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, duke përcaktuar zgjedhjen e saj me mandat të pjesshëm deri në vitin 2025. Ndërsa vlerësoj se kushtetutëbërësi nuk ka dashur të përcaktojë datë të saktë në ditë dhe muaj, e vetmja mënyrë për të përcaktuar datën kur mbaron qëndrimi në detyrë i gjyqtarës Holta Zaçaj është ajo bazuar në rregullat e përgjithshme të së drejtës. Rregullimet e Rregullores së Gjykatë plotësojnë dispozitat përkatëse të Kushtetutës dhe të ligjit organik dhe për çështje që nuk gjejnë rregullim në këto akte zbatohen dispozitat që rregullojnë procedurat civile, penale dhe administrative, sipas parashikimeve të kodeve përkatëse, duke pasur parasysh natyrën e çështjes konkrete në shqyrtim. Ndaj, në zbatim të nenit 148 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 56 të Kodit të Procedurave Administrative, që përcaktojnë se kur afati që është caktuar në javë, në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës që ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati, jam e qëndrimit se data e mbarimit të kohës së qëndrimit në detyrë të gjyqtarës Holta Zaçaj është dita e fundit e muajit të fundit të vitit 2025, konkretisht ora 23:59 e datës 31 dhjetor 2025.

20. Sipas shumicës “nga ana tjetër, edhe vetë gjyqtarja Holta Zaçaj, në kërkesën e saj për aplikim dhe në konfirmimin e kandidaturës pas rishpalljes së kësaj vakance, ka shprehur vullnetin e saj për të kandiduar për plotësimin e vendit vakant të krijuar nga mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, për pjesën e mbetur të mandatit që përfundon në muajin mars të vitit 2025” (shih paragrafin 25 të vendimit) dhe “gjyqtarja Holta Zaçaj në aktet e kandidimit ka shprehur vullnetin e saj për kohën e mbetur të këtij mandati, sipas shpalljes së vakancës” (shih paragrafin 35 të vendimit). Edhe ky argument nuk mund të shërbejë për Gjykatën, sa kohë që kandidatja Holta Zaçaj ka kandiduar dhe ka shprehur vullnetin të kandidojë për një vend vakant

në Gjykatën Kushtetuese që përcaktohej nga neni 179, pika 3, e Kushtetutës, do të thotë që ajo ka pranuar të qëndrojë në detyrë deri në vitin 2025. Edhe sa ajo ka shprehur dhe ka nënshkruar në letrat dhe aktet e kandidimit nuk konsiderohet vullnet për të pranuar interpretimin/leximin që i është bërë asokohe normës kushtetuese përmes një njoftimi të shpalljes së një vakance, por për të plotësuar dhe respektuar formalisht kërkesat e kandidimit.

21. Kjo nënkupton se njoftimi që ka bërë Gjykata e Lartë asokohe, në të njëjtën mënyrë si dhe qëndrimi që mban aktualisht kryetari i Gjykatës së Lartë, sa kohë që Kushtetuta dhe ligji nuk kanë një datë të përcaktuar, a ndonjë formulë të posaçme, pra specifike, që rregullon këtë situatë të veçantë, çdo vlerësim/qëndrim/qasje në njoftimin e vakancës nga kryetari i organit të emërtesës në detyrë në atë kohë, nuk përbën as ndonjë interpretim autoritar, as interpretim kushtetues, as detyruar për Gjykatën Kushtetuese o ndonjë organ/autoritet/individ tjetër. Jo më kot ka edhe një mospërputhje mes njoftimit të shpalljes së vakancës dhe vetë vendimit të Mbledhjes së Posaçme të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 16.01.2023, për zgjedhjen në detyrë të gjyqtares Holta Zaçaj, që nuk i referohet datës që ishte vendosur në njoftimin për shpalljen e vakancës, do të thotë datës 10 mars, por i referohet vetëm vitit 2025, në përputhje me përcaktimin e nenit 179, pika 3, të Kushtetutës.

22. Duke pasur parasysh sa është trajtuar më sipër, mandati i gjyqtares Holta Zaçaj është një mandat i pjesshëm (jo i plotë) por jo zëvendësues, i rregulluar në mënyrë të posaçme nga dispozita kalimtare kushtetuese, që do të thotë se **nuk ka si datë mbarimi**: i) as datën e fillimit dhe mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës (Vitore Tusha si gjyqtare paraardhëse); ii) as datën e betimit të gjyqtares Holta Zaçaj para Presidentit të Republikës, për sa kohë nuk është një mandat i plotë 9-vjeçar. Nëse Kushtetuta do të kishte dashur të bënte një rregullim të tillë ajo do të kishte përcaktuar në mënyrë të shprehur dhe të qartë datën e mbarimit të këtij mandati të pjesshëm (8-vjeçar).

23. Në përfundim, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, unë jam e qëndrimit se afati i qëndrimit në detyrë të gjyqtares Holta Zaçaj mbaron në datën 31 dhjetor 2025, pasi as Kushtetuta nuk ka përcaktuar ndonjë datë tjetër apo ndonjë ngjarje juridike nga e cila të mund të përcaktohet një datë e ndryshme dhe një qëndrim i ndryshëm nuk rezulton as në dispozitat e zbatueshme për zgjidhjen e kësaj çështjeje, apo praktika institucionale e kësaj Gjykate.

24. Në këto kushte, në situatën që as vetë Gjykata e Lartë si organ emërtese, aq më pak kryetari i saj, nuk ka kompetencën të konstatojë krijimin e vakancës dhe të shpallë/deklorojë kryesisht fillimin e procedurave për plotësimin e saj, qëndrimi i kryetarit të Gjykatës së Lartë, i pasuar me akte që kanë vënë në lëvizje një procedurë jokushtetuese, duhej të deklarohet si jokushtetues, sa kohë që ai përbën një precedent të rrezikshëm me pasoja të rënda në rendin kushtetues.

Anëtare: Sonila Bejtja